

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal,** gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit **M.V** nga fsh....., Komuna e ....., dhe mbrojtësi i tij avokat **A. J** nga ....., per shkak te vepres penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.2296-8/2017 të datës 15.11.2018, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit te Shtetit në Prizren Artnor Skoro, të akuzuarit, me datë **08.07.2019**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **M.V**, nga i ati R, dhe e ëma M, e vajzërisë K, i lindur më datë .... në ....., Komuna e ..., ku dhe tani jeton, ka të kryer shkollen e mesme, student, i pamartuar, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Se me dt.19.08.2017, rreth ores 15:00, në rrugën .... – ... të Komunës së ..., saktësisht në afërsi të fshatit ..., Komuna e ....., i pandehuri duke drejtuar automjetin e markës "...", me targa të regjistrimit ..., nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes me kushtet dhe rrethanat e rrugës, ku gjatë hyrjes në një kthesë të madhe, e humb kontrollin e drejtimit të automjetit, del nga rruga në anën e majtë dhe rrokulliset, me çrast vet i pandehuri dhe E. V pësojnë lëndime këto të konstatuara nga eksperti mjeko-ligjorë Dr. D. H. dh Dr. M. G.

-kësodore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 të KP-së,

**PRANOHET MARRËVESHJA**, për pranimin e fajesis ne mes te prokurorit te shtetit prane Prokuroris Themelore ne Prizren, Departamenti i Pergjithshem Penal, dhe te akuzuarit M.V, ne prezencen e mbrojtësit te tij av.A. J. me PP.nr.2296-8/2017 te dt.14.11.2018, per shkak te vepres penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 43, par.1 pika 1.3, 46, 49 par.1 p.1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 e 76 te KPK-se, dhe neni 365 te KPPK-es te akuzuarit i shqipton:

## D Ë N I M M E K U S H T

Ashtu qe i verteton denimin me burgim ne kohezgjatje prej **6 muajve** i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej **1 viti** nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktvendimi, nese i akuzuari nuk do te kryen ndonje veper te re penale.

Obligohet i akuzuari qe te paguaj shpenzimet e procedures penale sado qe te behen ato ne baze te llogaris se gjykates, si dhe shpenzimet ne emer te paushallit gjyqesor shumen prej **30,00 euro**, ne emer te ekspertizes se komunikacionit rrugor shumen prej **40,88 euro**, si dhe ne emer te ekspertizes mjeko-ligjore shumen prej **50,00 euro**, si dhe te shpenzimeve ne emer te kompenzimit te viktimave te krimit prej **30,00 euro**, te gjitha keto ne afat prej **15 ditëve**, pas plotfuqishmersise se ketij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr.2296-8/2017 te dt.15.11.2018, kunder te akuzuarit **M.V** nga fsh...., Komuna e ...., per shkak te vepres penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 te KP-se .

Gjithashtu Prokuroria Themelore ne Prizren – Departamenti i Pergjithshem Penal, sipas aktakuzes PP.nr. 2296-8/2017 te dt.15.11.2018, ne baze te nenit 233 te KPP-se, prokurori i shtetit dhe i akuzuari M.V me dt.14.11.2018 kane hyre ne marreveshje mbi pranimin e fajesis konform nenit 233 par.2 te KPP-se.

Gjykata me dt.08.07.2019, ka caktuar dhe ka mbajtur seancen lidhur me pranimin e marreveshjes mbi pranimin e fajesis, gjykata konform nenit 233 ka vleresuar marreveshjen mbi pranimin e fajesis, ka ndegjuar prokurorin e shtetit i cili ka perfaqesuar aktakuzen dhe marreveshjen mbi pranimin e fajesis, te akuzuarin ne prezencen e mbrojtesit te tij av.A. J dhe ka vleresuar se i akuzuari e ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimi te fajesis, pranimi eshte bere vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve me mbrojtesin e tij, ka vleresuar se nuk ka qene i detyruar ose i shtrenguar ne asnje menyre qe ta pranoj fajesin.

Prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzen PP.nr.2296/17 te dt.15.11.2018 dhe pas leximit shkurtimisht ka elaboruar marreveshjen mbi pranimin e fajesis me te cilen marreveshje te akuzuarit per vepren penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 te KP-se, ka propozuar qe te akuzuarit ti shqiptohet dënimi **me kusht në kohëzgjatje prej 6 muajsh**, nese i akuzuari ne afatin ligjor prej **1 viti** nuk do te kryej veper te re penale.

Gjykata ka vleresuar se pranimi mbeshtetet ne fakte dhe prova materiale te rastit konkret e te cilat jane paraqitur ne aktakuzen dhe ne provat materiale te paraqitura nga prokurori te pranuar nga i akuzuari si dhe nga deshmit tjera te paraqitura nga prokurori.

Gjykata është e bindur se janë permbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin 18 të nenit 233 të KPP-së, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajesis dhe pas perfundimit të ndëgjimit në seancën e shqyrtimit fillestar gjyqësor, i ka shqiptuar të akuzuarit për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KP-së, i ka shqiptuar dënimin me kusht nëse i akuzuari nuk do të kryej ndonjë veprë të re penale, duke pasur parasysh rrethanat posaqerisht lehtësuese për të akuzuarin, dhe se atë është i moshës relativisht të re, ka pranuar fajesin me marrëveshje të pershkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të perseris vepra të kështilla apo të ngjajshme të karakterit penal e që do të bëjë ndesh me Kodin Penal të Kosovës.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450, e 451 të KPPK-së.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

Marrëveshja prej këtij momenti hyn si provë në shkresat e lëndës.

Aktgjykimi me ditën e sotme është i plotëfuqishëm.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr. 1838/2018 të datës 08.07.2019**

**Sekretare Juridike**  
**Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari**  
**Fatmir Krasniqi**